



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
РЕПУБЛИКА E MAQEDONISË SË

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 96-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon.

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-3985/1 të datës 16.08.2023, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent sepse bëhet fjalë për denoncim anonim nga i cili nuk mund të jepet informacion shtesë për pretendimet e cekura.

Lënda me numër 12-3985/1 të datës 16.08.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Me datë 16.08.2023, një parashtrues i panjohur ka parashtruar denoncim për gjoja parregullsi në punësim në \_\_\_\_\_ "\_\_\_\_\_" \_\_\_\_\_, pas së cilës është konstatuar rasti me numër 12-3985/1 të datës 16.08.2023. Në denoncimin e dorëzuar thuhet se drejtori i shkollës në \_\_\_\_\_ "\_\_\_\_\_" \_\_\_\_\_ ka punësuar një person me shkallë dhe lloj arsimimi joadekuat për një pozitë të caktuar por jo të spikatur.

KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se nuk kishte elemente për veprimin e saj kompetent, për faktin se denoncimi anonim i paraqitur nuk kishte të dhëna të mjaftueshme për të specifikuar se çfarë tregohej, dhe për rrjedhojë nuk kishte mundësi për të dhënë informacion shtesë. , për këtë arsye mori vendim për refuzimin e kërkesës.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

pёrgatiti: P.B  
miratoi: G.T anёtar i KSHPK-sё

**KOMISIONI SHTETЌOR  
PЉR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
Kryetar,  
Biljana Ivanovska

